



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë, më 13.11.2017
Dokument parlamentar

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “BUXHETI I VITIT 2018”
(shqyrtimi në parim)

Drejtuar: Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Bazuar në nenin 79 pika 2 dhe 80 të Rregullores së Kuvendit, në datat 6, 7, 8, 10 dhe 13 nëntor 2017, Komisioni për Sigurinë Kombëtare shqyrtoi në parim projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2018”, për institucionet që ky komision ka në fushën e tij të përgjegjësisë si:

1. Ministrinë e Mbrojtjes;
2. Ministrinë e Brendshme;
3. Shërbimin Informativ Shtetëror;
4. Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve;
5. Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave;
6. Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar;
7. Shërbimin e Provës.

Në mbledhjet e komisionit morën pjesë përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilët bënë prezantimin në parim të projektbuxhetit për vitin 2018 dhe iu përgjigjen pyetjeve të anëtarëve të komisionit, ministrja e Mbrojtjes, ministri i Brendshëm, përfaqësues të Shërbimit Informativ Shtetëror, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve etj., të cilët bënë prezantimin e arritjeve për institucionet e tyre, problematikat, menaxhimin e buxhetit të vitit 2017 dhe pritshmëritë e objektivat që do të arrihen me anë të projektbuxhetit 2018.

Projektbuxheti 2018 starton një fazë të re të thellimit të reformave të ndërmarra gjatë katër viteve të kaluara duke u fokusuar në rritjen ekonomike dhe sjelljen më afër të shërbimeve publike te qytetari. Projektbuxheti 2018 do të ketë më shumë burime në dispozicion si rezultat i politikave fiskale të cilat do të vazhdojnë të bazohen në taksimin e ndershëm dhe uljen e informalitetit, e në të njëjtën kohë synon nxitjen e investimeve private strategjike në sektorët prioritarë. Është e rëndësishme të theksohet se projektbuxheti 2018

garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për zbatimin e pesë reformave në sektorë kyç të ekonomisë, si: reforma e ujit, reforma në drejtësi, reforma në administratën publike, reforma e menaxhimit të financave publike dhe reforma administrative-territoriale.

➤ **Komisioni për Sigurinë Kombëtare**, gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në parim, u fokusua më shumë në aspektet e buxhetit të cilat trajtojnë elementet financiare në rendin publik dhe sigurinë e vendit, ku analizoi me vëmendje buxhetin e parashikuar ndaj institucioneve të cilat janë përgjegjëse për çështjet e sigurisë dhe rendit publik apo dhe institucioneve që kontribuojnë në këto dy komponent, si Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ Shtetëror, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Shërbimi i Provës, DSIK dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave.

Anëtarët e Komisionit për Sigurinë Kombëtare gjatë diskutimit në parim i drejtuan pyetje të shumta Ministres së Mbrojtjes, Ministrin të Brendshëm përfaqësuesve të SHISH dhe institucioneve të tjera të thirrura për këtë qëllim, mbi prioritetet që këto institucione duan të arrijnë me anë të këtij projekt-buxheti si dhe nëse buxheti i parashikuar për ta, plotëson nevojat për ushtrimin normal të funksioneve dhe detyrave të tyre.

Projektbuxheti i vitit 2018 në mënyrë të përmbledhur për institucionet e thirrura dhe të cilat janë nën fushën e përgjegjësisë së Komisionit për Sigurinë Kombëtare, parashikon të arrijë:

MINISTRIA E BRENDSHME

Tre janë shtyllat kryesore që synohet të jetësohen gjatë vitit buxhetor 2018:

1. Lufta kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave, korrupsionit, kultivimit e trafikimit të lëndëve narkotike;
2. Forcimi i institucioneve si dhe rritja e kapaciteteve të punonjësve, vlerësimi i integritetit, profesionalizmit dhe performancës;
3. Rritja e standardeve të shërbimit ndaj qytetarëve.

Buxheti, i propozuar për vitin 2018, për Ministrinë e Brendshme është **21.1 miliard lekë** i cili në tërësinë e tij ka një rritje prej 8.4 % krahasuar me vitin 2017 ku veçanërisht investimet janë rritur me një vlerë rekord prej 71%.

Investimet e vitit 2018 janë fokusuar veçanërisht në 3 prej programeve të Ministrisë së Brendshme që kanë të bëjnë me sigurinë publike, konkretisht:

- 103% është rritja e buxhetit për Investime me financim të brendshëm për Policinë e Shtetit në krahasim me vitin 2017;
- Është dyfishuar buxheti për investime në Gardën e Republikës, në raport me buxhetin e vitit 2017;
- Është dyfishuar buxheti i investimeve për Drejtorinë e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në raport me buxhetin e vitit 2017.

MINISTRIA E MBROJTJES

Duke e krahasuar me vitin 2017, buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes ka një rritje sinjifikative, ku nga 13,039,500 në vitin 2017, për vitin 2018 janë parashikuar 19.797.838 lekë, dukshëm paraqitet si buxheti më i madh i parashikuar ndonjëherë që prej anëtarësimit të vendit në NATO.

Nëpërmjet Buxhetit të parashikuar për vitin 2018, Ministria e Mbrojtjes synon të arrijë këto objektiva:

- Rritja e operacionalitetit të FARSH në përmbushje të angazhimeve në kuadër të Aleancës. Më konkretisht, vijimi i pjesëmarrjes në operacionet e NATO-s duke rritur nivelin e angazhimit të FA, në operacionet e Aleancës në Afganistan dhe Kosovë apo në operacionet e BE-së në Bosnjë-Hercegovinë dhe Malin e Zi, si dhe pjesëmarrja në misionet e iniciativat e reja që NATO mund të ndërmarrë, në Irak/Detin Egje, etj.
- Zhvillimi i kapaciteteve të FA në përputhje me Planin Afatgjatë të Zhvillimit;
- Vijimi i modernizimit dhe pajisjes së Forcave Tokësore me armatim të ri të ndërveprueshme me aleatët në NATO. Investime në infrastrukturë për përmirësimin e mjediseve të punës dhe ushtarake.
- Zhvillimi dhe mbajtja në gatishmëri të kapaciteteve të FARSH për operacione të mbrojtjes kombëtare dhe kolektive, operacione në përgjigje të krizave, si dhe kapacitetet për përballimin e Emergjencave Civile, dhënien e ndihmës vendeve të rajonit në rast emergjencash civile në kuadrin e NATO-s, OKB-se dhe BE-se;
- Në strukturën e shpenzimeve kapitale (Investimet me financim të brendshëm e të jashtëm), vendin kryesor e zë modernizimi, me 92% të investimeve në total. Këtu futen dy kontratat, shumë të rëndësishme, Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të hapësirës ajrore”, dhe “Pajisja e anijeve patrulluese të klasit Iliria”.

❖ Nga dëgjesat e kryera si më sipër, Komisioni vlerëson se buxheti për dy ministritë përkatëse, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Mbrojtjes është i kënaqshëm dhe krahasuar me vitet e kaluara kanë ardhur në rritje si një ndër buxhetet më të mëdha të parashikuara ndonjë herë për to.

❖ Megjithatë, Komisioni gjykon se buxheti i akorduar për SHISH, DPPP, DSIK, Shërbimin e Provës dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, brenda mundësive financiare dhe sipas përparësisë duhet të rivlerësohen me qëllim rritje. Për këtë arsye Komisioni për Sigurinë Kombëtare vendosi ti kërkojë Komisionit të Ekonomisë, të ketë në konsideratë një rritje në zërin e investimeve dhe shpenzimeve operative për këto

institucione, kërkesë kjo e cila do të paraqitet edhe gjatë shqyrtimit të këtij projekt/buxheti nën për nen. Kërkesat për rritje fondesh konsistojnë për:

Shërbimi Informativ Shtetëror

Buxheti i vitit 2018 për SHISH, në krahasim me vitet e mëparshme vlerësohet pozitiv dhe deri diku përmbush detyrat kryesore për këtë shërbim i cili ka rol tepër të rëndësishëm për sigurinë kombëtare. Rritja e buxhetit (në terma të përgjithshme) nga 14 milion në 15 milion lekë tregon qartë synimin e qeverisë për forcimin dhe modernizimin e këtij shërbimi si nevojë për t'iu përgjigjur sfidave të rëndësishme në çështjet e sigurisë. Komisioni mbështet kërkesat e këtij shërbimi për rritje të fondeve buxhetore, sidomos për zërin e investimeve në pajisje të domosdoshme për këtë shërbim.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave (DPPPP)

Gjatë dëgjësës së DPPPP në komision, si dhe duke mbajtur në konsideratë funksionin dhe detyrat e saj në mbledhjen dhe administrimit e informacionit, koordinimin e punës me institucionet shtetërore për identifikimin dhe administrimin e informacionit për personat e shpallur si terrorist apo financues të terrorizmit në nivel ndërkombëtar, si dhe synimit për arritjen e rezultateve në zbulimin dhe zhdukjen e të gjitha kërcënimeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në ekonominë kombëtare, Komisioni mbështet kërkesat e DPPPP dhe gjykon se buxheti i parashikuar për të duhet të rritet, sidomos në zërin e investimeve. Kjo kërkesë vjen si rrjedhojë dhe e përmbushjes së detyrimeve që lindin në zbatim të standardeve ndërkombëtare të FATF dhe komitetit MONEVYAL të Këshillit të Europës.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)

Gjatë dëgjësës së DSIK në komision, si dhe duke mbajtur në konsideratë funksionin dhe detyrat e saj si Autoriteti i Sigurimit Kombëtar për organizimin, drejtimin dhe kontrollin e masave për ruajtjen, klasifikimin dhe administrimin e informacionit të klasifikuar, Komisioni mbështet kërkesat e kësaj Drejtorie dhe gjykon se buxheti i parashikuar për të duhet të rritet, sidomos në zërin e investimeve dhe shpenzimet operacionale.

Duhet mbajtur në konsideratë gjithashtu se si DSIK dhe DPPPP tashmë janë përfshirë si organe ndihmëse në procesin e vettingut, proces i cili përbën volum pune të shtuar për këto dy drejtori dhe që kërkon mbështetje financiare të nevojshme. Gjithashtu këto dy drejtori janë parashikuar të jenë pjesë përbërëse dhe kontribuojnë edhe në Task-Forcën Speciale të ngritur nga Ministria e Brendshme.

Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve.

Buxheti i parashikuar për këtë Drejtori duhet të ri konsiderohet pasi paraqet nevoja imediate për rritje për qëllim investime dhe mirëmbajtje të Burgjeve të reja të ngritura sipas

standardeve europiane. Rritja e buxhetit për Sistemin e Burgjeve mundëson funksionimin normal dhe ofron garanci se siguria në këtë sistem nuk cenohet, përkundrazi synohet të rritet dhe përmirësohet. Gjithashtu duhet të mbahet në konsideratë nevoja për uniforma të reja për Policinë e Burgjeve, pasi prej vitit 2004 ato nuk janë ndryshuar.

Shërbimi i Provës

Buxheti i parashikuar për këtë shërbim duhet të ri konsiderohet me qëllim rritje. Rritja e buxhetit për këtë shërbim kërkohet dhe justifikohet me qëllim zbatimin e parashikimeve të reja të Kodit Penal për të miturit që kanë probleme me ligjin.

➤ **Sa më sipër, Komisioni për Sigurinë Kombëtare në përfundim të diskutimeve, me shumicë votash vendosi të miratojë në parim pr/ligjin për buxhetin e vitit 2018 me sugjerimet përkatëse dhe dërgimin e këtij raporti Komisionit për Ekonominë dhe Financat.**

Kryetar

Ermonela (Felaj) VALIKAJ

Relator

Pjerin NDREU

Xhemal QEFALIA

Paulin STERKAJ

Sadi VORPSI

Elona Hoxha

Luan Duzha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë, më 24.11.2017
Dokument parlamentar.

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2018”
(shqyrtimi në nen për nen dhe në tërësi)

Drejtuar: Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat
Seancës Plenare

Bazuar në nenin 32-38 dhe 80 të Rregullores së Kuvendit, në datën 24.11.2017 Komisioni për Sigurinë Kombëtare shqyrtoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2018”, për institucionet që ky komision ka në fushën e tij të përgjegjësisë si:

8. Ministrinë e Mbrojtjes;
9. Ministrinë e Brendshme;
10. Shërbimin Informativ Shtetëror;
11. Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve;
12. Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave;
13. Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar;
14. Shërbimin e Provës.

Të ftuar për të marrë pjesë në diskutim dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve ishin përfaqësuesit e institucioneve përkatëse dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Pasi dëgjoji mendimin dhe vërejtjet e përfaqësuesve të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme, Shërbimit Informativ Shtetëror, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, DPPPP, DSIK dhe Shërbimit Provës si dhe pas diskutimeve të anëtarëve të tij, **Komisioni për Sigurinë Kombëtare**, vendosi me shumicë votash ta miratojë nen për nen dhe në tërësi pr/ligjin për Buxhetin e vitit 2018 dhe t’ia përcjell komisionit përgjegjës dhe seancës plenare me vërejtjet dhe sugjerimet si vijon.

I. Për Ministrinë e Mbrojtjes:

Komisioni dhe Ministria e Mbrojtjes ndajnë të njëjtin mendim se buxheti për vitin 2018 i parashikuar për këtë ministri është buxheti më i madh i akorduar ndonjëherë dhe

përbush detyrimet kushtetuese e ligjore për FA-të, nevojat operationale për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operationet e NATO-s apo misione të tjera ndërkombëtare.

II. Për Ministrinë e Brendshme

Ashtu si buxheti i parashikuar për Ministrinë e Mbrojtjes, edhe buxheti i parashikuar për Ministrinë e Brendshme paraqitet në nivele të kënaqshme, Komisioni gjykon se pr/buxheti për vitin 2018 për Ministrinë e Brendshme mbulon të gjitha nevojat e këtij institucioni mjaft të rëndësishëm për rendin dhe sigurinë publike, e për këtë arsye edhe për këtë ministri nuk ka vërejtje ose propozime konkrete në zërat buxhetorë.

Tre janë shtyllat kryesore që synohet të arrihen gjatë vitit buxhetor 2018:

4. Lufta kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave, korrupsionit, kultivimit e trafikimit të lëndëve narkotike;
5. Forcimi i institucioneve si dhe rritja e kapaciteteve të punonjësve, vlerësimi i integritetit, profesionalizmit dhe performancës;
6. Rritja e standardeve të shërbimit ndaj qytetarëve.

III. Shërbimi Informativ Shtetëror

Buxheti i vitit 2018 për SHISH, në krahasim me vitet e mëparshme vlerësohet pozitiv dhe i përshtatshëm në përbushjen e detyrave kryesore për këtë shërbim i cili ka një rol tepër të rëndësishëm për sigurinë kombëtare. Rritja e buxhetit të këtij viti ndaj vitit të kaluar 2017, është 5, 2 % ose në terma monetarë, 72 milionë lekë më shumë. Gjithsesi nevojat për t'iu përgjigjur sfidave të sigurisë paraqitet më e madhe për këtë shërbim dhe Komisioni mbështet kërkesat e tij për rritje të fondeve buxhetore për zërin e investimeve në pajisje të domosdoshme në funksion të detyrave kryesore të tij.

IV. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave (DPPPP)

Gjatë dëgjësës së DPPPP në komision, si dhe duke mbajtur në konsideratë përbushjen e detyrimeve që lindin në zbatim e standardeve ndërkombëtare të FATF dhe komitetit MONEVYAL të Këshillit të Europës, Komisioni mbështet kërkesat e DPPPP dhe gjykon se buxheti i parashikuar për të duhet të rritet në zërin e investimeve.

V. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)

Gjatë dëgjësës së DSIK në komision, si dhe duke mbajtur në konsideratë funksionin dhe detyrat e saj si Autoriteti i Sigurimit Kombëtar për organizimin, drejtimin dhe kontrollin e masave për ruajtjen, klasifikimin dhe administrimin e informacionit të klasifikuar, Komisioni mbështet kërkesat e kësaj Drejtorie dhe gjykon se buxheti i parashikuar për të duhet të rritet në zërin e investimeve dhe shpenzimet operationale. Duhet mbajtur në konsideratë gjithashtu dhe se DSIK dhe DPPPP tashmë janë parashikuar si organe ndihmëse në procesin e vettingut, proces i cili përbën volum pune të shtuar për këto dy drejtori dhe që kërkon mbështetje financiare të nevojshme. Gjithashtu këto dy drejtori janë parashikuar të jenë pjesë përbërëse dhe kontribuojnë edhe në Task-Forcën Speciale të ngritur nga Ministria e Brendshme.

VI. Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve.

Buxheti i parashikuar për këtë Drejtori duhet të rikonsiderohet pasi paraqet nevoja për rritje në drejtim të mirëmbajtjes të Burgjeve të reja të ngritura sipas standardeve europiane. Rritja e buxhetit për Sistemin e Burgjeve mundëson funksionimin normal dhe ofron garanci se siguria në këtë sistem të rëndësishëm nuk cenohet, përkundrazi synohet të rritet dhe përmirësohet. Gjithashtu duhet të mbahet në konsideratë dhe nevoja për uniforma të reja për Policinë e Burgjeve, pasi prej vitit 2004 ato nuk janë ndryshuar.

VII. Shërbimi i Provës

Buxheti i parashikuar për këtë shërbim duhet të rikonsiderohet me qëllim rritje. Rritja e buxhetit për këtë shërbim kërkohet dhe justifikohet me qëllim zbatimin e parashikimeve të reja të Kodit Penal për të miturit që kanë probleme me ligjin, Instituti i Shmangies.

✚ **KOMISIONI NË PËRFUNDIM TË DISKUTIMEVE**, me shumicë votash vendosi ta miratojë nen për nen dhe në tërësi pr/ligjin për buxhetin e vitit 2018 dhe t'ia përcjellë komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat dhe seancës plenare me këto sugjerime:

Për SHISH - për vitin 2018, në funksion të plotësimit me sukses të objektivave, mbështetja financiare që kërkohet mbi parashikimet është:

- a. në zërin e shpenzimeve dhe investime në shumën 560, 7 milionë lekë nga të cilat 54 milionë lekë në artikullin paga dhe sigurime për një shtesë 33 punonjësish në organikë;
- b. në artikullin 602 shpenzime për mallra dhe shërbime, shumën 64,9 milionë lekë
- c. në artikullin “investime”, shumën 441,7 milionë lekë.

✚ Komisioni mbështet dhe sugjeron se kërkesa më e konsiderueshme për shtesë fondi për SHISH është në zërin për investime, shuma 2 milionë euro, ose 274, 8 milionë lekë, e që ka për qëllim blerjen e sistemit për grumbullimin dhe analizimin e informacionit.

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve

Kjo drejtori kërkoi shtesë fondi në total 370 milion lekë, nga të cilat 182 milion lekë për mirëmbajtjen e Burgut të Shkodrës (Malësisë së Madhe) dhe 188 milion lekë për uniformat e Policisë së Burgjeve.

✚ Komisioni mbështet dhe sugjeron se kërkesa më e konsiderueshme dhe imediate për shtesë fondi për Drejtorinë e Burgjeve është në zërin për investime, shuma 188 milion lekë, me qëllim blerjen e uniformave për Policinë e Burgjeve pasi ka që prej vitit 2004 që uniformat nuk janë ndërruar.

Shërbimi i Provës

✚ Komisioni mbështet dhe sugjeron shtesë fondi për këtë shërbim në total 7.5 milion lekë, e specifikisht shtesë fondi prej 2.5 milion lekë në artikullin 602, dhe që lidhet me zbatimin e dispozitave të Kodit Penal për të miturit, instituti i ri ai i “Shmangies” si dhe 5 milion lekë shtesë për zërin 241.

DSIK

✚ Komisioni mbështet dhe sugjeron shtesë fondi për këtë në total 14 milion lekë, specifikisht për zërin e investimeve 7 milion lekë dhe për zërin 602, 7 milion lekë.

DPPPP

✚ Komisioni mbështetet dhe sugjeron shtesë fondi për këtë drejtori në total 7 milion lekë, shtesë kjo e kërkuar për zërin e investimeve.

➤ Sa më sipër, Komisioni për Sigurinë Kombëtare pasi miratoi nen për nen dhe në tërësi pr/ligjin për buxhetin e vitit 2018 me sugjerimet përkatëse, vendosi dërgimin e këtij raporti Komisionit për Ekonominë dhe Financat dhe Seancës Plenare.

Kryetar

Ermonela (Felaj) VALIKAJ

Relator

Pjerin NDREU